31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshhtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëshmëpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre në punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "**Force Madhore**" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe

përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përqipen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [gjuha shqipe].
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % ne afat prej 120 ditesh
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë [do të përcaktohet nga menaxheri i kontratës.]
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë [90 dite].
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit caktohet me vendim të ZKA-se.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [5 dite] pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është [365] ditë
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës , në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.

Rregullimi i Parkut në lagjen Arbëria - Prishtinë

PARAMASA

A. PUNËT E PARKUT

Kushte të përgjithshme:

Përshkrimi i punëve. Në përpuethshmëri të plotë me standartet EC dhe ISO.

Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këte mënyrë duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punishtes dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësinore në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punishtes.

Punishtja të rrethohet me tabela prej llamarine dhe me konstrukcion të përforcuar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheh edhe çyqajen e instalimeve ekzistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikyqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konzervimin të instalimeve ekzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.

Për çdo ndryshim të mundshëm në projekt gjatë realizimit të punimeve duhet të konsultohet organi mbikëqyrës dhe projektantin.

Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakterisika të ngjajshme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standartet EC dhe ISO.

Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vuarjen në vepër të materialeve për secilin pozicion

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma (€)
1	Punimet Përgaditore				
1.1	Ingjizimi gjeodezik i lokacionit Sipas Specifikacioneve teknike, si dhe percjellja e punëve në vazhdimi me instrumentet gjeodezike.	m ²	24,731.41	€ 0.30	€ 7,419.42
1.2	Furnizimi me material dhe punimi i rrethojës së pushishtes me tabela prej llamarinës dhe me konstrukcion të përforcuar mirë në tokë. Lartësia e rrethojës h=2.0 m	m'	440.00	€ 0.50	€ 220.00
1.3	Instalimi i zyreve të perkohshme në punishte (~12m ² /copë). Vendosja e tyre bëhet në bashkëpunim me organin mbikqyrës.	copë	1.00	€ 500.00	€ 500.00
1.4	Instalimi i perkohshëm i instalimeve komunale (uji, mbeturinat, rryma me njësjor-nga rrjeti, gjeneratori.)	copë	1.00	€ 150.00	€ 150.00
				Shuma 1:	€ 8,289.42
2	Punimet e dheut dhe mbushjet				
2.1	Pastrimi, grumbullimi dhe sipërimi i të gjitha mbeturinave që gjenden në këte sipërfaqe për trajtim, materialet largohen në deponi legale deri në 15km, të percaktuar nga organi mbikqyrës.	m ²	24,731.41	€ 0.20	€ 4,946.28
2.2	Eskavimi dhe deponimi, planifikimi dhe kompaktësimi i shtresës humusore d=30cm. Eskavime bëhet edhe nën platot e demoluara. Pozicioni përfshinë edhe transportin e materialit të tepërt deri në një deponi legale apo ndonjë vend tjetër të caktuar nga org. mbikqyrës ose Komuna deri në 15km.	m ³	2,356.31	€ 1.40	€ 3,298.83
2.3	Planifikimi dhe kompaktësimi i sipërfaqeve të eskavuara, para hudhjes së materialit mbushës me modul të ngjeshjes 20Mpa	m ²	7,854.36	€ 0.40	€ 3,141.74
2.4	Sjellja, shpërndarja, planifikimi dhe kompaktësimi i shtresës humusore të skarpeve (mbushje humusi) me trashësi prej 20 cm për përshtatjen e terrenit për mbjelljen e barit të ri adekuat. Në rastet e skarpeve me pjerrtësi të madhe mbropa mureve B.A ngjeshja e dheut bëhet në shtresa shtresa me nga 20 cm duke përfshirë të gjitha lag -jet e nevojshme në mënyrë që të pengohet rrëshqitja e dheut.	m ²	21,954.41	€ 0.80	€ 17,563.53
2.5	Germimi i dheut të kategorise III-IV për punimin e shtresave të shetitoret, hapsirat e lodrave, shkallet dhe themelet e fushes së sportit. Pozicioni përfshinë edhe transportin e materialit të tepërt deri në deponin e caktuar nga org. mbikqyrës 15 km.	m ³	3,670.15	€ 1.20	€ 4,404.18
2.6	Blerja, furnizimi, planifikimi dhe kompaktësimi i materialit zhavorik për mbushje çakull (0-150) me modul të ngjeshjes 40Mpa. Materiali përdoret të fusha dhe në hapsirat e lodrave.	m ³	2,380.63	€ 8.00	€ 19,045.04
2.7	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyesi d=0-60mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktësimi 50Mpa, t=20 cm. Në çmim të parashihen edhe të gjitha shpenzimet e nevojshme për shqyrtimin e ngjeshmërisë. Materiali përdoret në staza për kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m ³	1,157.63	€ 9.00	€ 10,418.67
2.8	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyesi d=0-30mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktësimi 70Mpa, t=10cm. Në çmim të parashihen edhe të gjitha shpenzimet e nevojshme për shqyrtimin e ngjeshmërisë. Materiali përdoret në staza për kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m ³	639.20	€ 9.00	€ 5,752.80

2.9	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyesi d=4-32mm, mbushjet, planifikimi ne shtres horizontale 30cm anash murit. Ne qmim te kalkulohet edhe gjeotekstili 300 gr/m ² per ndarjen e zhavorit, S=264 m ² . Materiali perdoret per drenazhimin e ujrave nentoksor te muret.	m ³	35.00	€ 9.00	€ 315.00
2.10	Blerja, furnizimi dhe vendosja e gypave drenazhues Ø160. Materiali perdoret per drenazhimin e ujrave nentoksor te muret.	m'	120.00	€ 2.50	€ 300.00
2.11	Blerja, furnizimi dhe vendosja e gypave PE- Ø40. në muret mbrojtëse të fushës, në çdo 2 m'. Materiali përdoret për drenazhimin e ujërave nëntokësorë te muret.	m'	150.00	€ 2.00	€ 300.00
				Shuma 2:	€ 69,486.08
3	Punimet e betonit				
<i>Klasa e betonit per te gjitha pozicionet eshte C30/37. Te gjitha atestet dhe shqyrtimet e nevojshme te perfshihen ne çmim (numri i shqyrtimeve caktohet nga prgani mbikqyres), Te gjitha panellet (kallepet) e pjeseve te dukshme te betonit te lyhen dhe te jene te kualitetit te larte ne menyre qe te permbushen edhe kriteriet e larta vizual-eestetike te siperfaqeve te betonuara. Kriteret estetike te permbushen edhe gjate betonimit te shkalleve, tribinave, rampave - te gjitha siperfaqeve të dukshme.</i>					
3.1	Sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi me Beton C-20 MPa, mirëmbajtja e betonit për punimin e shtresave mbrojtëse te armatures me trashesi mesatare t=6.0 cm nen themelet e mureve mbrojtës te fushes, nen themelet e mureve të këndit të fitnesit dhe kendit te lojrave	m ³	54.00	€ 65.00	€ 3,510.00
3.2	Punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi, armimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve për punimin e shkallëve, anësoreve të shkallëve të parkut si dhe themelet e veqara te rrethojes ne mes fushave.	m ³	29.00	€ 70.00	€ 2,030.00
3.3	Punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi, armimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve për punimin e murit ne pjesen e siperme te kendit i lodrave dhe kendit te fitnesit	m ³	64.00	€ 65.00	€ 4,160.00
3.4	Punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi, armimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve per punimin e fushes se sportit, Muret mbrojtëse betona arme, tribinave për spektator dhe elementeve tjera kosnruktive. Rrafshimi dhe tekstura e siperfaqes se betonit duhet te jet e paster.	m ³	498.00	€ 65.00	€ 32,370.00
3.5	Punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi, armimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve per punimin e pllakes se fushes se sportit me trashesi t=15.0 cm , Rrafshimi duhet te behet me makina perkatese	m ³	352.50	€ 65.00	€ 22,912.50
					€ 64,982.50
4	Punimet e Armimit per muret mbrojtëse dhe muret e rampave				
Vërejtje:					
4.1	Lloji i armaturave të përdorura janë Sipas detaleve ne projekt: Armatura S-500;				
4.2	Furnizimi me material si, pregaditja dhe vendosja ne vend e armatures për themelet, mureve mbrojtëse, shkalleve, tribinave dhe pllakave të dyshemeve nga goma sipas llogaris statike dhe spec. teknik.	kg	38,800.00	€ 0.67	€ 25,996.00
4.3	Furnizimi me material si, pregaditja dhe vendosja e rrjetave Q-335 ne siperfaqen e fushes ne pllaken beton arme t=15.0 cm me palim se paku 40 cm'	kg	14,215.00	€ 0.67	€ 9,524.05

35520.05

5		Punët e dyshemesë prej gome					
5.1	<p>Furnizimi me material dhe punimi i gomes në fushen e sportit, kendet e lojrave dhe stazave për ecje, sipas kesaj renditje</p> <p>1.Shtruerja e shtresës nga betoni i armuar me trashësi 15cm me armaturë rrejtë Q-355 (betoni dhe rrjetat janë e llogaritur ne pozicionet e mesipërme) duke punuar dilatatimet e nevojshme me modul 24m² (për fushë të sportit dhe kënde të lodrave) ndërsa çdo 6m² për stazat e ecjes. Betonit ti shtohet aditivi për rezistencë ndaj lageshtisë.Ti kushtohet kujdes nivelimit dhe evitimit të gropave dhe deformimeve gjatë betonimit.</p> <p>2.Punimi i dyshemesë nga goma me shtresë të dyfishtë : sistemi me spërkatje (spraycoat). Struktura bazë të jetë e punuar nga granulat SBR -gomë e recikluar 1-3,5 mm , e ngjitur me ngjitës adekuat dhe shtresa e epërme me stërpikje me poliuretane dhe granula EPDM :0,5 - 1,5 mm dhe EPDM puder 0.0 -0,5mm-dy herë. Produkti ti plotësojë standardet DIN V 18035-6, EN-14 977, IAAF ose të ngjajshme. Trashësia e tërë shtresave min. 13 -14 mm.Të gjitha shtresat e dyshemesë të jenë sistem i një prodhuesi duke përfshirë edhe ngjitësat adekuat. Ky pozicion të realizohet medeomos nga stafi profesional i trajnuar për realizim të produktit dhe në tërësi sipas udhëzimeve të prodhuesit (temp. minimale dhe temp. maksimale gjatë realizimit, lagështia e ajrit, rreet Uv etj.)përfshirë edhe pastrimin paraprak të bazës dhe pregaditjen e nënbazës . Të ofrohet garancioni në prodhim/material (min. 5 vite) dhe në realizim (min. 3 vite). Obligim i punëkryesit është sigurimi i materialit dhe prodhimit gjatë realizimit dhe mbrojtja nga ndikimet atmosferike (të reshurat, dielli etj.). Kjo dysheme punohet te fusha e sportit dhe shtegu për jogging. Punëkryesi gjatë ofertimit të prezantojë katalogun e materialit - prodhuesit dhe metodologjinë e realizimit. Pozicioni llogaritet me çmim njësi.</p> <p>Vërejtje: Pjerrtësia e terenit duhet të jetë 2-3%</p>	m ²	2,350.00	€	14.00	€	32,900.00
5.2	<p>Furnizimi, Punimi dhe montimi i konstruksionit metalik me diametër Ø125mm duke përfshirë tabelen e basketbollit duke llogaritur edhe përforcimet në bazament me pllaka të hekurit 400 x 400 x10mm,ankorimin e bulonave Ø20mm gjatësi 80cm vendosjen-saldimin e pllakës me konstruksion metalik 400x 400 x 10mm.</p> <p>Vërejtje: Për shtylla duhet të punohet edhe bazamenti nga betoni armeja C-25/30 me dim.100 x 100 x 80cm duke llogaritur edhe tamponin nën bazament me trashësi t=20cm.</p> <p>Lartësia,vendi dhe gjatësia e vendosjes së shtyllave do të bëhet sipas normave sportive. Të përfshihen të gjitha ankerimet e nevojshme për këtë pozicion.</p>	copë	2.00	€	350.00	€	700.00
5.3	<p>Furnizimi dhe montimi i portes se footballit me dimensione sipas vizatimit ne detal te prodhuara nga shtylla te celikut me seksione ovale 120 X100 mm, skajet gjithashtu duhet te jene te perforcuara. Ne cmim duhet te perfishihen edhe ankeret nga celiku komplet me kapak dhe shufrat e hekurta te ngjyroshura qe sherbejne per perforcimin e rrjetes, si dhe rrjeta. Lartësia,vendi dhe gjatësia e vendosjes së shtyllave do të bëhet sipas normave sportive.</p>	copë	2.00	€	500.00	€	1,000.00
5.4	<p>Furnizimi me material si dhe montimi i unazës së koshit me susta, në çmim duhet të parashihet edhe rrjeta për unazë të basketbollit në përputhje me standardet teknike.</p>	copë	2.00	€	50.00	€	100.00
5.5	<p>Furnizimi me material si dhe punimi i vijave për basketboll.</p> <p>Pozicioni përfshinë të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional, të gjitha materialet duhet ti plotësojnë standardet teknike evropiane të parapara për këtë aktivitet.</p> <p>Llogaritja bëhet për m².</p>	m ²	130.30	€	2.30	€	299.69
5.6	<p>Furnizimi me material si dhe punimi i vijave për football.</p> <p>Pozicioni përfshinë të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional, të gjitha materialet duhet ti plotësojnë standardet teknike evropiane të parapara për këtë aktivitet.</p> <p>Llogaritja bëhet për m².</p>	m ²	180.00	€	2.30	€	414.00

5.7	Furnizimi , prerja, saldimi dhe punimi I rrethojës metalike sipas detalit në projekt. Lartësia e rrethojës është H=4.10 m. Në pozicion të përfshihen ankerimet e nevojshme, saldimet, shtyllat vertikale, horizontalet, mbushjen me rrjet Ø8 qdo 15 cm të kufizuara me profila L , pllakat lidhëse mbyllësat përfundimtare, lyereja me një ngjyrë dhe dy shtresa finale nuanca e gjelbërt. Llogaria në m ² të rrethojës. Vërejtje :shiqo detalin (Detali i Rrjetës, fleta Nr.12)	m ²	545.50	€	18.00	€	9,819.00	
5.8	Furnizimi, prerja, saldimi dhe vendosja e derës hyrëse dy krishe me dimensione 255x400 cm, të inkuadruar në rrethojën nga materiali dhe dizajni I njejtë si I rrethojës, në çmim të llogaritur ngjyroja dhe mekanizimi për hapje dhe mbyllje. Vërejtje :shiqo detalin.	m ²	12	€	35.00	€	420.00	
							€	45,652.69
6	Paisjet për fitness, lodrat, gjelberimi dhe materialet dekorative							
	<i>Paisjet për fitness dhe rekreim në hapësirë të hapur. Paisjet të jenë të prodhuara fabrikisht nga prodhuesi I specializuar në këtë lloj të prodhimit me produkte të kualitetit të lartë me siguri të posaçme të shfrytëzimit të produktit , me funksionalizim, dizajn atraktiv dhe rezistencë të madhe ndaj vandalizmit dhe kushëve atmosferike. Të gjitha paisjet të jenë të punuara sipas standardeve ISO 14001 dhe ISO 9001. Produkti të mos përmbajë kimikale të dëmshme. Çdo paisje të përmbajë udhëzimin e përdorimit dhe përshkrimin e funksioneve . Konstruksioni bazë i produkteve të jetë nga çeliku, të mbrojtura me ngjyrë ekologjike me sistem pudër ose zallim, të gjitha në ngjyrë orange. Çmimi përfshin furnizimin, transportin dhe montimin në tërësi sipas udhëzimit të prodhuesit. Ofertuesi të prezantojë katalogje të prodhuesit të specializuar.</i>							
6.1	Furnizimi me material si dhe montimi I paisjes për fitnes me shtytje në drejtim poshtë lart dy ulëse të vendosura në një shtyllë për fëmijë e dedikuar për moshën mbi 12 vjet (Angl. Push Up Bars). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe të gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (DETALI I LODRAVE "1"), fleta 20.	copë	1.00	€	170.00	€	170.00	
6.2	Furnizimi me material si dhe montimi I ulëses për fitnes e dedikuar për moshën mbi 15 vjet (Angl. Pull Down). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe të gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (DETALI I LODRAVE "2"), fleta 21.	copë	1.00	€	120.00	€	120.00	
6.3	Furnizimi me material si dhe montimi I varësive për fitnes të vendosura në një shtyllë për dy persona e dedikuar për moshën mbi 15 vjet (Angl. Upper Body Trainer). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe të gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (DETALI I LODRAVE "3"), fleta 22.	copë	1.00	€	140.00	€	140.00	
6.4	Furnizimi me material si dhe montimi I varësive për fitnes të vendosura në një shtyllë për dy persona e dedikuar për moshën mbi 15 vjet (Angl. Upper Body Trainer). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe të gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (DETALI I LODRAVE "4"), fleta 23.	copë	1.00	€	90.00	€	90.00	
6.5	Furnizimi me material si dhe montimi I luhatësës për fëmijë të vegjël (swings). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe të gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (LUHATËSJA), fleta 26.	copë	1.00	€	110.00	€	110.00	
6.6	Furnizimi me material si dhe montimi I lodrave për fëmijë të vegjël paraleles për ngritje poshte-larte(seesaws).Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe të gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (DETALI I LODRAVE "6"), fleta 28.	copë	2.00	€	130.00	€	260.00	
6.7	Furnizimi me material si dhe montimi I lodrave për fëmijë të vegjël, lodrat me suste për levizje (Ang. Springers). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe të gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (DETALI I LODRAVE "8" dhe "9"), fleta 25, 27.	copë	2.00	€	90.00	€	180.00	

Gjelbrimi dhe pemët dekoruese					
6.8	Furnizimi, transporti, mbjellja dhe mirëmbajtja e gjelbërimit- barit Italian deri në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e duhur për zhvillim me dendësi 30-40 gr/m ² ose sipas udhëzimit të prodhuesit si dhe furnizimin dhe mbulimin me një shtresë te imet dheu pas mbjelljes, rrafshimin me ngjeshje me cilindër të dorës/kopshtarit prej 50-60 kg.	m ²	21,954.41	€ 0.20	€ 4,390.88
